

VENDIM
Nr. 715, datë 24.11.2021

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E
RIKONSTRUKSIONIT OSE TË RIPARIMIT TË MJEDISEVE NË BASHKËPRONËSI
OSE TË PËRBASHKËTA NË NDËRTESA (PALLAT), NË BASHKITË TIRANË,
DURRËS DHE MIRDITË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 25 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 824 836 517 (tetëqind e njëzet e katër milionë e tetëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e shtatëmbëdhjetë) lekë, për financimin e rikonstruksionit ose të riparimit të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallat), në bashkitë Tiranë, Durrës dhe Mirditë, sipas detajimit të mëposhtëm:

- a) Bashkisë Tiranë i transferohet fondi, në masën 240 000 000 (dyqind e dyzet milionë) lekë;
- b) Bashkisë Durrës i transferohet fondi, në masën 388 182 835 (treqind e tetëdhjetë milionë e njëqind e tetëdhjetë e dy mijë e tetëqind e tridhjetë e pesë) lekë;
- c) Bashkisë Mirditë i transferohet fondi, në masën 196 653 682 (njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e dy) lekë.

2. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2021, në masën 164 967 303 lekë (njëqind e gjashtëdhjetë e katër milionë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e treqind e tre) lekë, për financimin e rikonstruksionit ose të riparimit të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallat), në bashkitë Tiranë, Durrës dhe Mirditë, sipas detajimit të mëposhtëm:

- a) Bashkisë Tiranë i transferohet fondi, në masën 48 000 000 (dyzet e tetë milionë) lekë;
- b) Bashkisë Durrës i transferohet fondi, në masën 77 636 567 (shtatëdhjetë e shtatë milionë e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë;
- c) Bashkisë Mirditë i transferohet fondi, në masën 39 330 736 (tridhjetë e nëntë milionë e treqind e tridhjetë mijë e shtatëqind e tridhjetë e gjashtë) lekë.

3. Efekti financiar, për vitin 2021, të përballohet nga hapësira buxhetore e siguruar pas ngurtësimit në të njëjtën masë të fondeve të projekteve të rindërtimit me ecuri të ngadaltë dhe t’u transferohet bashkive Tiranë, Durrës dhe Mirditë në formën e transfertës së pakushtëzuar.

4. Ngarkohen zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Tiranë, Durrës dhe Mirditë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj